



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 138/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në përbërje nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi Kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Besianë, paraqitur kundër Halim Muçolli kandidatë për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radha e Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Besianë, për shkak të vendosjes të banerit mbi rrugë publike për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), ndërsa Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Besianë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja për Vetëvendosje (LVV) dega në Besianë, në të cilën pretendohet se me datën 04.06.2014 rreth orës 11:52 kanë vërejtur se mbi rrugën “Zahir Pajaziti” në Besianë ishte vendosur baneri i kandidatit për deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës Halim Muçolli me numër 107 nga radhët e LDK-së. Andaj pretendohet se me këtë veprim është bërë shkelje e nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013 të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë një fotografi dhe emrin e një dëshmitari.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4, paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, me datë 05.06.2014 e informoi subjektin politik LDK-në, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të jap përgjigje në ankesë, dhe i ka dhënë Urdhër për të Ndërmarr Masat Përmirësuese lidhur me ankesën deri më datë 06.06.2014, në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK, me të cilën theksohet se pasi që është njoftuar për ankesën që është ushtruar nga LVV, ka kontaktuar Shtabin Zgjedhor në Besianë dhe me datë 04.06.2014 pas orës 12:00 janë larguar te gjithë banerat në rrugën “Zahir Pajaziti” dhe “Skenderbeu” në Besianë të kandidatit Halim Muçolli dhe si provë kanë bashkangjitur fotografi në të cilat shihet që nuk ekzistojnë banerat në atë vend.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës se subjekti politik LDK ka vendosur banerin mbi rrugën publike “Zahir Pajaziti” në Besianë, janë të qëndrueshme ngase konstatohen nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti i njëjtë politik ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik LDK, pas marrjes së Kërkesës për dhënien e përgjigjes në ankesë, dhe Urdhërit të PZAP-it për të Ndërmarr Masa Përmirësuese, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke e larguar banerin nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstatoi se subjekti politik LDK ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parasheh se “*Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore*” duke pasur parasysh se nga ana e subjektit politik LDK është larguar baneri në fjalë, menjëherë pas marrjes së Kërkesës për dhënien e përgjigjes në ankesë, dhe Urdhrit të PZAP-it, për të Ndërmarr Masat Përmirësuese, që nënkupton se është bërë evitimi i shkeljes së supozuar në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura në Përgjigjen në ankesë dhe të Urdhërit për të Ndërmarr Masa Përmirësuese, e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, andaj në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 138/2014 më datën 06.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*